



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1721/2 Prishtinë 10.07. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Dijellëza Zogjani** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Relacionet ndërmjet kostos dhe planifikimit dinamik kohorë tek projektet e ndërtimit** ” në programin e studimeve Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

ABSTRAKT

Ky hulumtim synon të eksploroj dhe të analizoj relacionet ndërmjet planifikimit dinamik kohor dhe kostos tek projektet e ndërtimit. Planifikimi dinamik kohor është një metodologji e zhvilluar për të menaxhuar dhe kontrolluar kohën e projekteve të ndërtimit duke përdorur teknika dhe mjetet e sofistikuar të planifikimit. Kostoja, nga ana tjetër, është një aspekt kritik i çdo projekt ndërtimi dhe menaxhimi i saj është sfidues dhe kompleks.

Rezultatet e këtij studimi do të ofrojnë një kuptim më të thellë në mënyrën se si planifikimi dinamik kohor mund të ndikojë në performancën e kostos së projekteve të ndërtimit. Do të shqyrtohen faktorët që influencojnë kostot dhe si ndryshimet në planifikimin kohor mund të ndikojnë në to. Përmes analizës së rastit studimor, do të identifikohen marrëdhëniet dhe lidhjet ndërmjet kohës së planifikuar, kohës së realizuar dhe kostos së projektit.

Rasti studimor merr në konsideratë projektin e rehabilitimit të hekurudhës në Kosovë. Qëllimi i hulumtimit është të përcaktoj dhe demonstroj rëndësinë e planifikimit të kohës dhe të kostos përpara fillimit të procesit të ndërtimit dhe të përcaktoj kostot dhe artikujt kyç që mund të gjenerojnë kostot më të larta gjatë ndërtimit. Ky studim mund të kontribuojë në literaturën ekzistuese të menaxhimit të projekteve të ndërtimit, duke adresuar një temë të rëndësishme për relacionet ndërmjet planifikimit dinamik kohor dhe kostos. Rezultatet dhe konkluzionet e këtij studimi mund të përdoren si udhërrëfyes për inxhinierët, menaxherët dhe profesionistët e fushës për të përmirësuar praktikën dhe performancën në menaxhimin e projekteve të ndërtimit.

Fjalët kyçe: projekt, menaxhim, planifikimi kohor, kosto.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimitarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimitarisë.